

1. NDËRTIMI I NJË REZERVUARI PËR UJË TË PIESHËM

Projekt për ndërtimin e një rezervuari të madh për ujë për pije për të gjithë vendbanimet e komunës së Bogovinës, i cili do t'i furnizojë rezervuarët aktual të secilit vendbanim, posaçërisht gjatë stinës së verës kur sasia e ujit për pije zvogëlohet.

2. DIGJITALIZIMI I TË GJITHA SHKOLLAVE NË KOMUNËN E BOGOVINËS

Planifikojmë t'i digjitalizojmë të gjitha shkollat në nivel lokal, si dhe të gjitha klasat të pajisen me pajisje moderne teknologjike si SMART TABLE , PROJEKTORË etj

3. THEMELIMI I NJËSISË PËR ZJARRFIKËS BOGOVINË-VRAPÇISHT

Njësia për zjarrfikës është e domosdoshme andaj komuna e Bogovinës dhe e Vrapçishtit kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për këtë projekt ku planifikohet ndërtimi dhe themelimi i njësisë së zjarrfikësve si njësi e përbashkët për të dy komunat rurale. Mjetet për implementimin e këtij projekti do të sigurohen nga IPA FONDET E Bashkimit European .

4. NDËRTIMI I QENDRËS DITORE PËR FËMIJË ME NEVOJA TË VEÇANTA

Gjatë menaxhimit të komunës së Bogovinës në 4 vitet e kaluara ne projektua një projekt themelor për ndërtimin e një qendre ditore për fëmijët me nevoja të veçanta dhe me të njëjtën aplikuam tek Ministria e punës dhe politikës sociale. Janë siguruar të gjitha mjetet e nevojshme për ndërtimin e të qendrës, ndërsa punimet për ndërtimin e saj pritet të fillojnë në muajin Nëntor.

5. NDËRTIMI I SHTRATIT TË LUMIT BOGOVINË-ZHERVOJAN

Gjatë stinës së vjeshtës komuna jonë ballafaqohet me shira të rrëmbyeshëm që paraqesin rrezik për vendbanimin në Bogovinë dhe rrethinë nga vërshimet e mundshme. Mjetet për këtë projekt janë siguruar nga UNDP dhe Ambasada e Zvicrës, kurse punimet do të nisin së shpejti.

6.VAZHDIMI I INSTALIMIT TË RRJETIT TË KANALIZIMIT FEKAL NË GJITH TERRITORIN E KOMUNËS SË BOGOVINËS

Gjatë këtij mandati arritëm që të sigurojmë mjete financiare për katër vendbanime të komunës sonë: Bogovinë, Kamjan, Pirok dhe Pallçisht. Punimet për instalimin e rrjetit të kanalizimit fekal ve[më kanë filluar në Bogovinë dhe Kamjan. Gjatë katër viteve të ardhshme planifikojmë që ky projekt të përfshijë gjithë vendbanimet e komunës sonë.

7.NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT PËR VENDBANIMIN PALLÇISHT

Mjetet për implementimin e këtij projekti janë siguruar nga Banka Evropiane për investime. Punimet për ndërtimin e ujësjellësit për vendbanimin Pallçisht pritet të fillojnë këtë vit.

8. NDËRTIMI I RRUGËS SEDLARCË-KAMJAN-PALLÇISHT-KALLNIK PËRRETH AUTOSTRADËS TETOVË-GOSTIVAR.

Ky projekt mundëson krijimin e një rruge alternative për të gjithë banorët e komunës së Bogovinës me Tetovën dhe njëkohësisht krijimin e një zone ekonomike në tokat përreth autostradës Tetovë-Gostivar.

9. NDËRTIMI I KËNDEVE PËR LOJRA NË ÇDO VENDBANIM TË KOMUNËS SË BOGOVINËS

Duke u nisur nga ajo se fëmijët janë ardhmëria e vendit tonë, ne planifikojmë të ndërtojmë kënde për lojëra në çdo vendbanim.

10. SHITIGJE PËR KËMBËSORE PËR TE LIQENI I BOGOVINËS NGA VENDBANIMET RAKOVEC, NOVOSELLË DHE JELLOVJAN .

Liqeni i Bogovinës është atraksion turistik mjaft i vizituar, por rruga për të arritur tek ai është e vështirë dhe e rrezikshme. Me këtë projekt do të mundësohen shitigje për këmbësorë si një lehtësim për të gjithë ata që duanë ta vizitojnë liqenin e Bogovinës.

11 NDËRTIMI I SALLËS SPORTIVE NË BOGOVINË

Ndërtimi i sallës sportive në Bogovinë do të fillojë në vitin 2022 .